

Bibël për fëmijët paraqet



Gruaja Tek Pusi

Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Lazarus

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Adaptuar nga: Ruth Klassen

Tregimi 47 nga 60

www.M1914.org


Bible for Children, PO Box 3, Winnipeg, MB R3C 2G1 Canada

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.


Shqip

Albanian


Jezusi dhe dishepujt e Tij po udhëtonin nëpër vendin e Samarisë. Ata mbërritën në një vend të quajtur Sihar.



Atje ishte një pus, ku njerëzit e Siharit mbushnin ujë për të pirë. Jakobi, ati i Izraelitëve e kishte hapur pusin shumë kohë më parë.



Herët pasdite, dielli digjte dhe bënte shumë vapë. I lodhur, Jezusi u ul pranë pusit, ndërsa dishepujt shkuan në Sihar për të blerë ushqim.



3


Jezusi ishte krejt vetëm - por, jo për shumë kohë. Një grua, që jetonte në Sihar erdhi për të mbushur ujë.



4


"Më jep të pi", i tha Jezusi asaj.

Gruaja u habit. "Si ka mundësi që ti, duke qenë Jude, kërkon ujë nga unë, një grua Samaritane?!" tha ajo. Në ato ditë, Judenjtë nuk shkonin mirë me Samaritanët!




5

Ajo, mbase u befasua edhe më shumë, kur Jezusi i tha: "Nëse ti e di kush Jam Unë, ti do të më kërkojë Mua ujë të gjallë".



6

Gruaja i tha Jezusit: "Zotëri, ti nuk ke asgjë me çfarë të nxjerrësh ujë, dhe pusi është i thellë; nga pra do ta nxjerrësh atë ujin e gjallë"? Mos je gjë më i madh se ati ynë, Jakobi, që na e dha këtë pus ..."?




7

"Kushdo që pi nga ky ujë, do të ketë përsëri etje", i tha Jezusi gruas.




8



"Por, kushdo që pi nga uji që Unë do ti jap, nuk do të ketë kurrë etje. Uji që Unë do ti jap ... do të bëhet në të burim uji që gufon në jetë të përjetëshme".
"Zotëri, më jep këtë ujë", tha gruaja.

9




Jezusi, i tha kësaj gruaje të shkojë e të thërrasë burrin e saj. "Unë nuk kam burrë", u përgjigj gruaja. "Ti ke pasur pesë burra", i tha Jezusi, "dhe ky që ke tani nuk është burri yt".


10

Gruaja kuptoi që Jezusi ishte një profet. Ajo u përpoq ta bënte Atë të argumentonte se ku duhet adhuruar Perëndia: në Jerusalem, apo në malin e shenjtë të Samarisë. Jezusi i tha asaj, se adhuruesit e vërtetë e adhurojnë Perëndinë në Frymë dhe në të vërtetë.

"Unë e di që Mesia do të vijë", i tha gruaja Jezusit. "Kur Ai të vijë, Ai do të na tregojë gjithçka". Unë që po të flas, Jam Ai", i tha Jezusi asaj. Pikërisht në atë çast, dishepujt u kthyen sërish. Gruaja e la qypin e shtrenjtë tek pusi dhe u kthye në qytet.



11



12



"Ejani, shihni një Njeri që më tregoi gjithçka që kam bërë", i tha gruaja njerëzve të Siharit.

13



"A mundet të jetë ky Krishti"? Njerëzit dolën nga qyteti dhe erdhën të shohin Jezusin me sytë e tyre.


14

Ndërkohë, dishepujt i thanë Jezusit të hajë. Por, Jezusi u tha, "Ushqimi im është të bëj vullnetin e Atij që më dërgoi, dhe të mbaroj punën e Tij". Puna e Tij ishte të sillte njerëzit tek Perëndia.




15

Shumë nga Samaritanët, besuan për shkak të fjalëve të gruas. Ata i kërkuan Jezusit të qëndrojë me ta; dhe ai qëndroi atje dy ditë.




16

Shumë të tjerë besuan për shkak të fjalëve të vetë Jezusit.



17

Ata thanë, "... ne e kemi dëgjuar vetë dhe e dimë se në fakt ky është Krishti, Shpëtimtari i botës".



18

Gruaja Tek Pusi

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Gjionit 4

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."
Psalmet 119:130

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Denimi për mekatin është vdekja.

Perëndia na don neve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdes në Kryq dhe të paguaj dënimin tonë. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lartë në Qiell.

Nëse ti do që të pendohesh, thuaja këtë Perëndisë: Perëndi i dashur, unë besoj në Jezusin që vdiq për mua dhe jeton. Të lutem eja në jetën time dhe m'i fal mëkatet, në mënyrë që të kem jetën e re. Dhe që të jem me Ty përgjithmonë. Më ndihmo që të jetoj për Ty si fëmija i Yt. Amen. Gjoni 3:16

Lexo Biblën dhe fol me Perëndinë çdo ditë!

